

NEWSLETTER

Prill

Pjesëmarrja në
“FSHN-UT
Open Day”.

Rezultatet e
tremujorit të parë
2025 – ALBSIG Jetë.

Pashka në Albsig
– Harmoni, traditë
dhe momente të
paharruara.

Zyrë e re Albsig në
zemër të Tiranës –
më afër se kurrë!

Tremujori i parë
2025 – Albsig
forcon pozitat si
lider në tregun e
sigurimeve.

ALBSIG, partner
në AI Business
Summit 2025.

Raporto dëmin
online me Albsig.



Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Pjesëmarrja në “FSHN-UT Open Day”

Në datën 23 Prill 2025, ALBSIG mori pjesë në panairin “FSHN-UT Open Day, Studim – Eksperiençë – Karrierë”, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ky event mbledhi një audiencë të gjërë studentësh dhe profesionistësh të fushave të ndryshme, duke ofruar një mundësi ideale për ndërveprim të drejtpërdrejtë me të rinjtë që kërkojnë mundësi praktike, punësimi apo bashkëpunimi.

ALBSIG prezantoi produktet dhe shërbimet e saj në një stendë të dedikuar, ku u shpërndanë materiale informuese dhe promovuese. Gjatë gjithë aktivitetit, përfaqësuesit tanë ishin në kontakt të vazhdueshëm me pjesëmarrësit, duke dhënë informacione të dobishme mbi fushën e sigurimeve dhe mundësitë e karrierës që kompania jonë ofron.



Pashka në Albsig

Harmoni, traditë dhe momente të paharruara

Festat janë më shumë sesa një shënim në kalendar — ato janë një mundësi për t'u ndalur, për të reflektuar dhe për të krijuar kujtime të bukura së bashku. Në Albsig, e kemi kthyer tashmë në traditë që çdo festë të shërbejë si një moment për të forcuar lidhjet midis nesh dhe për të rikujtuar vlerat që na bashkojnë.

Me rastin e Pashkëve, stafi ynë u mbledh në ambientet e ngrohta të **@foodlovers_al** për të festuar në një atmosferë të qetë dhe plot ngjyra. Ngjyrosja e vezëve, një simbol i kësaj feste, u kthye në një aktivitet që solli jo vetëm krijimtari, por emocione dhe qetësi.


Secili prej pjesëmarrësve kontribuoi në mënyrën e vet, duke sjellë qasje unike — nga ata që shfaqën kujdes në përzgjedhjen e ngjyrave dhe detajeve estetike, te ata që sollën humor dhe gjallëri, duke krijuar një ambient të ngrohtë dhe mikpritës për të gjithë.

Veçantia e këtij aktiviteti u pasurua edhe më tej me përgatitjen e një cheesecake-u të përbashkët, i cili u shijua me shumë kënaqësi. Ky gjest i thjeshtë përforcoi edhe një herë idenë se bashkëpunimi dhe ndarja e momenteve të përzemërta janë po aq të rëndësishme sa arritjet tona profesionale.

Në Albsig, kujdesi ndaj njëri-tjetrit dhe kultivimi i një kulture të shëndetshme organizative mbeten gjithmonë në zemër të çdo iniciative. Momente të tilla janë dëshmi e frymës së respektit, solidaritetit dhe bashkëpunimit që na karakterizon.









Tremujori i parë 2025

Albsig forcon pozitë si lider në
tregun e sigurimeve.

Albsig

vazhdon të dëshmojë një performancë të shkëlqyer në tregun e sigurimeve, duke u renditur si kompania më e besuar nga individët dhe bizneset shqiptare. Të dhënat e publikuara nga **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)** për tremujorin e parë të vitit 2025 konfirmojnë qartë rritjen, stabilitetin dhe efikasitetin e kompanisë sonë.



Lider në sigurimet vullnetare

Albsig kryeson bindshëm me **57.24% të totalit të primeve në produktet vullnetare**, ndërkohë që mesatarja e tregut qëndron në **33.18%**. Ky tregues është një dëshmi e drejtpërdrejtë e besimit që klientët vazhdojnë të kenë ndaj ofertës së Albsig, si dhe e aftësisë sonë për të ndërtuar produkte të personalizuar dhe me vlerë të shtuar për qytetarët dhe bizneset.



Shpejtësi në menaxhimin e dëmeve

Në datën **31 mars 2025**, Albsig shënoi **numrin më të ulët të dëmeve të pezull (të papaguara)** në të gjithë tregun. Kjo tregon jo vetëm efikasitetin operacional të kompanisë, por edhe prioritetin që i jepet trajtimit të drejtë dhe të shpejtë të çdo kërkesë për dëmshpërblim — një prej pikave më të rëndësishme në vlerësimin e cilësisë së një shoqërie sigurimesh.



Renditja e parë në produktet strategjike

Albsig mban **pozicionin e parë** në disa nga linjat më të rëndësishme të sigurimeve, përfshirë:

- Sigurimin Kasko
- Përgjegjësinë e Ndërtuesit
- Sigurimet e Garancisë
- Sigurimin nga Zjarri dhe Rreziqet Shtesë, duke përfshirë edhe rreziqet inxhinierike dhe sigurimin ndaj vjedhjes

ALBSIG Jetë:

Rezultatet e tremujorit të parë 2025



ALBSIG Jetë vijon të konsolidojë pozicionin e saj si një nga kompanitë më të rëndësishme në tregun e sigurimeve të jetës, duke reflektuar besueshmëri, stabilitet dhe fokus të vazhdueshëm te nevojat reale të klientëve.



Renditja e dytë në tregun e sigurimeve të jetës

Për periudhën **Janar — Mars 2025**, ALBSIG Jetë zë një pjesë prej **31.54%** të tregut total të sigurimeve të jetës, duke u renditur në **vendin e dytë** në nivel kombëtar. Kjo pjesë e tregut tregon rritjen e vazhdueshme dhe përhapjen e besimit që individët dhe institucionet kanë ndaj produkteve tona të jetës.



Vend i parë për produktin e sigurimit “Jetë për hua”

Brenda këtij segmenti, ALBSIG Jetë kryeson tregun me produktin **“Jetë për hua”**, duke zënë një pjesë prej **37.75%** të këtij tregu për tremujorin e parë të vitit. Ky rezultat pasqyron një partneritet të suksesshëm me institucionet financiare dhe një menaxhim të shkëlqyer të këtij produkti të domosdoshëm për mbrojtjen financiare të klientëve që marrin kredi.

Rezultatet e ALBSIG Jetë për tremujorin e parë janë dëshmi e angazhimit tonë të përditshëm për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe të sigurta për jetën, duke kontribuar në një treg më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm financiarisht.

Zyrë e re Albsig në zemër të Tiranës — më afër se kurrë!

Nga tani, jemi edhe më pranë klientëve tanë — Albsig ka hapur zyrën më të re në një nga lokacionet më ikonike të kryeqytetit: Sheshi Skënderbej. E vendosur në një pikë strategjike dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjithë qytetarët, kjo zyrë do të ofrojë të gjitha shërbimet tona të sigurimit me të njëjtin standard profesionalizmi dhe kujdesi që na karakterizon.

Hapja e kësaj zyre është pjesë e angazhimit tonë për t'u zgjeruar me kujdes dhe për të qenë gjithmonë aty ku klientët kanë më shumë nevojë për ne — në qendër të jetës së përditshme, pranë bizneseve, institucioneve dhe komunitetit. Jeni të mirëpritur të na vizitoni për informacione, këshillim dhe çdo nevojë që lidhet me sigurimin tuaj.





Hellenic Business Association of Albania
Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri

AI BUSINESS SUMMIT

Powered by **accenture**



**ALBSIG, partner në
AI Business Summit 2025**

Më 24 Prill 2025, ALBSIG mori pjesë si partner në **AI BUSINESS SUMMIT 2025**, një ngjarje madhore e organizuar në bashkëpunim me **Accenture**, në ambientet e **Innovation Hub, Piramida**.


Duke mbështetur këtë samit si sponsor, ALBSIG riafirmoi angazhimin e tij ndaj **inovacionit dhe teknologjisë** si shtylla të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të sigurimeve dhe për transformimin digjital të shërbimeve ndaj klientit.




Samiti mbledhi mbi **150 pjesëmarrës**, përfshirë drejtues të industrisë, politikëbërës dhe ekspertë të inteligjencës artificiale, duke krijuar një hapësirë ku u shkëmbyen ide, eksperiencë dhe vizione për të ardhmen.

Për ALBSIG, ky partneritet shërbeu si një mundësi e vyer për të rritur **dukshmërinë e markës**, për të forcuar pozicionimin si një kompani që përqafon risitë dhe për të ndërtuar marrëdhënie të reja me vendimmarrës nga fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë.

Pjesëmarrja në këtë event theksoi edhe një herë orientimin strategjik të ALBSIG për të qenë **afër inovacionit dhe afër klientëve**, në një treg që po evoluon me ritme të shpejta.





Raporto dëmin online me Albsig! Thjeshtë, shpejt dhe në mënyrë të sigurt.

Në Albsig, ne besojmë se kujdesi ndaj klientit nuk ndalet kur mbyllet një kontratë sigurimi — përkundrazi, fillon aty ku ndodhin ngjarjet e papritura. Prandaj kemi krijuar një shërbim të ri online, që ju lejon të raportoni dëmet shëndetësore, në pronë apo përgjegjësi ndaj palëve të treta (TPL) direkt nga telefoni apo kompjuteri juaj, pa asnjë nevojë për të ardhur fizikisht në zyrë.

Çfarë lloj dëmsh mund të raportoni online?

1 Sigurimi i Shëndetit

Në rast të shpenzimeve mjekësore, ekzaminimeve apo ndërhyrjeve të mbuluara nga polica e sigurimit tuaj.

2 Sigurimi i Pronës

Për dëme në banesa, dyqane apo objekte të tjera të siguruara nga zjarri, vjedhja, përmbytjet apo rreziqe të tjera të mbuluara.

3 Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta (TPL)

Për dëme të shkaktuara ndaj personave të tretë, siç mund të jetë aksidenti me mjet apo dëmtimi i pronës së dikujt tjetër.


Si ta raportoni dëmin?

1. Vizitoni faqen www.albsig.al
2. Shkoni në butonin "Raporto Dëmin Online"
3. Zgjidhni llojin
4. Plotësoni formularin me të dhënat e kërkuara
5. Ngarkoni dokumentet mbështetëse (kartela mjekësore, foto, procesverbale etj.)
6. Shtypni "Dërgo"

Menjëherë pas dorëzimit, do të merrni një konfirmim automatik, dhe një specialist i Albsig do të marrë kontakt me ju për të vijuar procedurën.

Përfitimet për klientin:

- Kurseni kohë: Raportimi zgjat më pak se 10 minuta
- Pa letra, pa printera: E gjithë procedura është 100% online
- Në çdo moment, kudo: Në zyrë, në shtëpi apo gjatë udhëtimit
- Siguri dhe konfidencialitet maksimal



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL